



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

**BURSA PASUNIVERSITARE NË ITALI, VITI AKADEMIK 2015-2016**

Ambasada e Republikës së Italisë njofton se Qeveria e Republikës së Italisë ofron për studentët dhe të diplomuarit shqiptarë bursa studimi pasuniversitare për një total prej 54 muajsh (për 620 Euro/muaj) për vitin shkollor 2015 – 2016.

Me qëllim lehtësimin e procesit të formimit të nivelit të II-të, këtë vit do të pranohen vetëm kandidatët, të cilët dëshirojnë të ndjekin kurse universitare të nivelit II-të, Master të nivelit të I dhe të II, kurse në Doktoratë, shkolla specializimi (përfshihen degët mjekësore), kurse të ndryshme AFAM, kurse të avancuara të gjuhës dhe kulturës italiane, si dhe kurse formimi për mësues të gjuhës italiane. Shtojmë gjithashtu se pranohen aplikime edhe nga ata kandidatë, të cilët gjatë vitit shkollor 2014-2015 kanë përfutur bursa studimi në kurse universitare nivelit të parë dhe të ciklit unik, por përparësi do të kenë kandidatët e rinj për marrjen e bursës. Bursat e studimit mund të kenë një kohëzgjatje prej 3, 6, 9 muajsh ose 1 mujore për kurset e formimit për mësues të gjuhës italiane.

Periudha e përfutimit të bursës përkon me kohëzgjatjen e vitit shkollor 2015/2016, pra nga data 1 tetor 2015 deri në datën 30 shtator 2016. Megjithatë bursat e studimit do të fillojnë të paguhen vetëm duke filluar mbas datës 1 janar 2016. Bursat e studimit mund të kryhen pranë universiteteve, instituteve të formimit të lartë artistik e muzikor, instituteve të restaurimit, shkollave kombëtare të kinematografisë, qendrave e laboratorëve kërkimorë, bibliotekave, arkivave, muzeve dhe institucioneve të tjera shtetërore.

Nuk do të jepen bursa pranë Institucioneve të huaja edhe pse të vendosura në Itali apo në shkollave dhe laboratorëve private, të cilat nuk janë të njohura nga institucionet shtetërore.

Procedura e paraqitjes së kërkesës për bursë studimi nga ana e kandidatëve është informatizuar tërësisht. Kandidati duhet të plotësojë formularin interaktiv në faqen e internetit të Ministrisë së Punëve të Jashtme italiane:

<http://borseonline.esteri.it/borseonline>;

Gjatë fazës së paraqitjes së kërkesave, për çdo paqartësi mund t'i referoheni adresës së e-mail të Institutit të Kulturës italiane në vijim: [iictirana.borse@esteri.it](mailto:iictirana.borse@esteri.it);

Afati i fundit për përcjelljen telematik të formularit *online* është data **31 maj 2012**. Gjatë plotësimit të formularit duhet të shkarkohet në sistem një kopje e faqes me të dhënat anagrafike të pasaportës.

Kandidatët, të cilët kanë përfunduar procedurën e përshkruar më lart, duhet që brenda datës **27 maj 2015** të dorëzojnë pranë Institutit të Kulturës italiane (Sheshi Skënderbej;

Pallati i Kulturës; kati II, Tiranë; Tel: +355 4 2379580; Fax: +355 4 2379577)  
dokumentacionin që do t'u kërkohej edhe me e-mail dhe që përfshin:

1. Formularin e aplikimit të nënshkruar duke vendosur datën një fotografi në format pasaporte (bashkangjitur);
2. Titujt e studimeve të kryera (jo më tepër se 2 faqe), si dhe titujt shkencorë të mundshëm;
3. Për punonjësit e Administratës Publike (përfshi këtu profesorët e universiteteve) letra e drejtuesit (Shefi i Katedrës/Departamentit, Drejtori i Entit, etj.) duke motivuar kërkesën për bursë;
4. Dëshminë (ligjërish të njohur nga Shteti Italian) që vërteton njohjen e gjuhës italiane. Paraqitja e kësaj dëshmie përbën përparësi në përzgjedhjen e kandidatëve;
5. *Dichiarazione di intenti*, në italisht;
6. Letër prezantimi e kandidatit nga profesor që shërben si pikë referimi. Për kandidatët në kurset universitare të nivelit të dytë, të Masterit ose të Doktoratës nevojitet një letër prezantimi të paktën nga një autoritet akademik shqiptar (Rektor, dekan ose Drejtues Departamenti). Për kandidatët në kurset universitare të nivelit të dytë, Master ose Doktoraturë, nevojitet një letër reference nga ana e një autoriteti akademik shqiptar (p.sh. Rektori, Dekani ose Drejtori i Departamentit).

Kandidatët e Doktoraturës, duhet të paraqesin gjithashtu edhe dokumentet:

1. Përshkrimin e Projektit (deri në 1 faqe) që kandidati synon të realizojë, duke saktësuar emrin e institucionit pranë të cilit dëshiron të kryejë veprimtarinë e tij, si edhe kontaktet me personalitetet shkencore dhe akademike;
2. Letrën e një profesori apo eksperti italian, që është i gatshëm të ndjekë kandidatin gjatë veprimtarisë së parashikuar në projekt. Profesori/eksperti duhet të jetë docent ose ekspert përgjegjës i Institutit universitar/shkencor italian ku kandidati synon të zhvillojë aktivitetin e parashikuar në projektin e tij. Letra duhet gjithashtu të jetë e plotësuar me kokën e institucionit përkatës, si dhe e pajisur me vulën dhe firmën përkatëse. Duhet gjithashtu që letrat të përmbajë emrin, mbiemrin dhe kontaktet e personit që nënshkruan, për të lejuar verifikimin në rast se dyshohet mbi vërtetësinë e tyre.

Përzgjedhja e kandidatëve, të cilët do të plotësojnë kushtet për sa më sipër, do të kryhet nga një Komision i posaçëm i kryesuar nga Ambasada e Italisë në Tiranë, në të cilën do të bëjë pjesë, sikurse dhe në vitet e mëparshme, një funksionar i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit e Republikës së Shqipërisë.

Instituti Italian i Kulturës në Tiranë do të ofrojë ndihmesë në përpilimin e kërkesave dhe në përcaktimin e institucioneve pranë të cilave mund të përftohet bursa, si dhe do të vlerësojë nëse njohuritë në gjuhën italiane janë të përshtatshme për të përfitur nga periudha e studimit.

## **DREJTORIA E INTEGRIMIT DHE PROJEKTEVE**